

WALL CREAM

BOJË TRASPIRANTE, PËR SIPËRFAQE TË BRENDSHME ME MBULIM TË LARTË

SERI 453

PËRSHKRIMI

Wall Cream është bojë traspirante për aplikim të brendshëm, me fuqi të lartë mbuluese dhe shkallë përhapjeje të lartë. Wall Cream është bojë e formuluar për përdorim profesional, lejon dhënien e rezultateve estetike të shkelqyera me kosto relativisht të ulëta.

Wall Cream aplikohet lehtë dhe është shumë e përshtatshme për aplikim në sipërfaqje të brendshme me kondensim sic janë kuzhinat, banjo etj.

INSTRUKSIONE PËR PËRDORIM

E aplikueshme në:

- Sipërfaqe betoni.
 - Sipërfaqe gipsi dhe kartonxhesi.
 - Bojëra të vjetra dhe veshje me natyrë organike ose minerale, të thata, kompakte, absorbuese dhe kohezive.
 - Konglomerate me natyrë minerale ose absorbuese.
- Sipërfaqet përgatiten sipas shpjegimit në paragrafin "Përgatitja e sipërfaqes". Mos aplikoni në sipërfaqe të freskëta (të sapo lyera).

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

- Natyra e kordonit: Rezinë vinilike në dispersion ujor.
- Dendësia UNI EN ISO 2811-1: $1,72 \pm 0,05$ kg/l
- Viskoziteti i paketimit UNI 8902: 45000-50000 cps në 30 °C (viskozimetër rrotullues Brookfield)
- Tharja (në 25 °C dhe 65% të U.R.): në kontakt pas 30 min; shtresa tjetër pas 5 orësh.

PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Sipërfaqe murale:

-Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e tharë mirë dhe plotësisht kompakte me murin. Nëse është nevojë duhet bërë konsolidimi me produkte specifike.

- Në prani të mykut trajtoni sipërfaqen me detergjentin COMBAT 222 cod. 4810222 dhe me detergjentin COMBAT 333 kod. 4810333 (I cili penetron në brendësi/thellësi të sipërfaqes). Shtoni, nëse është nevojë higjienizuesin COMBAT 444 cod. 4810444.
 - Hiqni, duke zmeriluar ose me larje, mykun dhe pluhurat e bojës së vjetër. Eliminoni shtresa të ngritura të bojës në gëlqere ose tempera.
 - Largoni me zmerilim pluhurat, smogun dhe të tjera.
 - Niveloni parregullsitë e sipërfaqes dhe trajtoni vrimat, çarjet në sipërfaqe me TAMSTUCCO 9400006/9410110. Mbyllni çarjet me stuko të përshtatshme.
 - Hiqni stukaturen dhe plasaritjet me letër zmerile, pastroni pluhurin.
 - Kryeni zbutje në sipërfaqe me RASAMIX 9440160 ose me BETOMARC 9450150 ose me RASOMARC 9500150 nv bazë të llojit të sipërfaqes.
 - Aplikoni një shtresë IDROFIS 4700006 astar akrilik me bazë uji ose astarin e mikronizuar pa tretës ATOMO 8840001. Në kartonxhes aplikoni astarin specifik PREPARA 4710019 të pigmentuar. Në përgjithësi në sipërfaqe me shumë pluhur në prezencën e trashësisë së ulët të bojës traspirante të vjetër ose bojës në kushte të këqija përdorni astarin izolues me tretës ISOMARC 4410111 ose astarin e mikronizuar pa tretës ATOMO 8840001.
 - Vazhdoni me aplikimin e Wallcream sipas mënyrës së përshkruar në udhëzimet për aplikim.
 - * (Hollimi I astarit dhe sasia për t'u aplikuar janë në funksion të absorbimit të sipërfaqes dhe përcaktohen me prova paraprake në sipërfaqe specifike. Konsultohuni me skedën teknike përkatëse).
- #### UDHËZIMET E APLIKIMIT
- Kushtet e ambientit dhe sipërfaqes:
Temperatura e ambientit: Min. +8 °C / Max. +35 °C
Lagështira relative e ambientit <75%

WALL CREAM

BOJË TRASPIRANTE, PËR SIPËRFAQE TË BRENDSHME ME MBULIM TË LARTË

SERI 453

Temperatura e sipërfaqes: Min. +5 °C / Max. +35 °C
Lagështira e sipërfaqes: <10%
-Mjetet: Penel, rrul, furçë dhe pistoletë.
-Nr. shtresave: të paktën 2 shtresa.
-Hollimi: Shtresa e parë 70-75% ujë, shtresa e dytë 40-45%.
-Në aplikimin me pistoletë hollimi varet nga presioni i ushtruar dhe aparatura e përdorur.
-Pastrimi i mjeteve bëhet menjëherë pas përdorimit, me ujë.
-Shkalla e mbulimit: 8-10m²/l për shtresë dhe i referohet aplikimit në sipërfaqe lisho dhe mesatarisht absorbuese.

NGJYRIMI

Ngjyrimi bëhet nëpërmjet sistemit Tintometrik Marcromie.
Produkti mund të ngjyroset gjithashtu me kolorantë të Bravocasa seria 408P (vetëm për tonalitete të hapura) dhe me kolorantë COLORADO serie 548.
Në rastin e përdorimit të prodhimve të ndryshme, këshillohet përzjerja e tyre për të shmangur ndryshime të vogla në tonalitete.

MAGAZINIMI

Temperatura maksimale e ruajtjes: +30 °C
Temperatura minimale e ruajtjes: +5 °C
Produkti preferohet të përdoret deri në 2 vjet pas datës së prodhimit nëqoftëse është ruajtur në kontejnerët origjinalë të pahapur dhe në kushtet e temperaturës adekuate.

TË DHËNA MBI SIGURINË

Vlera limite e BE Dir. (Dir. 2004/42/EC)
Cat. A: bojë opake për mure të brendshme (shkelqimi <25@60°) (baze uji): 75 g/l (2007) / 30 g/l (2010)
Wall Cream përmban max: 30 g/l VOC
Produkti nuk kërkon rietiketim sipas D.L. 65 të 14/03/03 dhe modifikime ose azhornime.
Përdorni produktin sipas normave aktuale të higjienës dhe sigurisë; pas përdorimit mos i

hidhni kovat në ambient, i lini të thahen mirë mbetjet dhe i trajtoni ato si të vecanta.
Mbajini larg fëmijëve. Përdoreni në vende të mirë ventiluara. Në rast kontakti me sytë, i lani menjëherë me ujë të bollshëm. Në rast të gëlltitjes konsultohuni menjëherë me mjekun dhe i tregoni etiketën ose paketimin.
Mos hidhni mbetjet në kanalizime, korsi ujore ose në terren.
Për më shumë informacion konsultohuni me skedën e sigurisë.

SPECIFIKIMET

Bojë traspirante për brenda me fuqi të lartë mbuluese.
Aplikimi, në sipërfaqe të brendshme të parapërgatitura për bojën traspirante Wall Cream me kod. 4530319, me baze rezine vinilike në dispersion ujor, në të paktën 2 shtresa, në sasinë e caktuar të absorbimit të sipërfaqes.
Furnizimi dhe instalimi i materialit € për m².

SAN MARCO GROUP garanton që informacionet e kësaj skede janë marrë nga eksperiencia e saj dhe nga njohjet e saj teknike dhe shkencore; megjithatë nuk mund të mbajë asnjë përgjegjësi për rezultatet e arritura duke qenë se kushtet e aplikimit janë jashtë kontrollit të saj. Këshillohet të verifikohet gjithmonë efikasiteti i produktit. Skeda e paraqitur anulon dhe zëvendëson çdo skedë të mëparshme. Për informacione të mëtejshme teknike kontaktoni në nr.pa pagesë të Asistencës Teknike 800853048.